

## **Informacion mbi kontratën**

### **Mirëmbajtje e rrjetit aktiv të pozicionimit global “ALBCORS”**

Kontratë Shërbimi nr. 334/5 prot, datë 11.11.2019, lidhur midis palëve Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik “LAND&CO” shpk, me NIPT J87730202A, në cilësinë e Kontraktuesit, me objekt **“Ndërtimi i pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike, Faza II”**, me anë të së cilës është bërë i mundur ndërtimi i rrjetit aktiv të pozicionimit global “ALBCORS”, i përbërë nga 27 Stacione CORS dhe një qendër monitorimi e vendosur pranë ASIG.

Pjesë e kësaj kontrate është edhe “Mirëmbajtja e rrjetit aktiv të pozicionimit global “ALBCORS””, për një periudhë 4-vjeçare, proces i cili është në vazhdim prej muajit Janar 2020.

Vlera totale për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes për 4 vite është: 5 800 000 (pesë milion e tetëqind mijë) lekë, pa tvsh dhe 6 960 000 (gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, me tvsh.

Detyrimet e Kontraktorit për përmbushjen e këtij shërbimi janë:

Funksionimi i rrjetit aktiv të pozicionimit global “ALBCORS” (27 stacione CORS dhe qendra e monitorimit) pa ndërprerje dhe sipas kushteve teknike të kontratës, duke siguruar:

- Mbështetje dhe ndihmë 24 orë në ditë për 7 ditë të javës.
- Mbështetje ”on-line” nëpërmjet internetit, telefonisë ose e-mail me ASIG.
- Kontroll fizik në terren për mirëmbajtjen e stacioneve bazë dhe zgjidhjen e problematikave të hasura.